



KOMUNA E PRISHTINËS

RAPORT

Drejtoria	Drejtoria e Shëndetësisë
Periudha Raportuese	Gusht, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Dr. Bujar Gashi, drejtor i DSH-së
Përgatitur	Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në DSH

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit gusht 2020, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi lëndë të ndryshme për t'i shqyrtuar nga stafi i saj dhe nga komisioni profesional. Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Monitorim dhe mbështetje të aktiviteteve bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saja, si dhe në QMU;
- Identifikimi i nevojave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në kuadër të KPSH;

- Inicimi i përgatitjeve administrative zbatimi i planprokurimit 2020;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Identifikimi i nevojave rreth përpilimit të specifikave:
 - Furnizim me inventar për nevojat e objekteve shëndetësore – KPSH;
 - Furnizim me pajisje mjekësore – KPSH;
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
- Monitorim i aktiviteteve:
 - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së objektit QMU;
 - Furnizim me barna dhe material shëndetësor mjekësor;
 - Furnizim me material shpenzues stomatologjik;
- Publikim për ofertim:
 - Furnizim emergjent me reagensë serologjik për testim të # Covid 19;
- Përcaktim i stafit vlerësues për aktivitetin:
 - Pastrimi i objekteve shëndetësore KPSH në komunën e Prishtinës;
- Nënshkrimi i kontratës “Grumbullimi, transportimi dhe asgjësimi i mbetjeve mjekësore KPSH në komunën e Prishtinës”;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin QKMF dhe QMU në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
 - Me prioritet, ndërmarrjen e masave preventivë rreth parandalimit të korona-virusit;
 - Njoftim i vazhdueshëm rreth riorganizimit të personelit shëndetësor mbi gatishmërinë e përhapjes së korona-virusit;
- Gjatë muajit gusht 2020, ishin 1395 raste pozitive me # Covid -19;
- Zhvillohen faza e pestë, shtesë e dezinsketimit hapësinor në komunën e Prishtinës;
- Në QKMF në shumicën e njërive të saj (15 QMF), fillon sistemi i caktimit të vizitave, përmes lidhjeve telefonike pa pagesë, në secilën njësi.



Kështu që, qytetarët e Prishtinës tashmë kanë mundësi që të telefonojnë QMF-në më të afërt, (aty ku rëndom i marrin shërbimet e kujdesit shëndetësorë) dhe të caktojnë vizitën mjekësore, tek mjeku i tyre familjar.

- Përpilim të dhënash nga Drejtoria e Shëndetësisë mbi vlerësimin e performancës për vitin 2019 të Komunës së Prishtinës – MAPL;
- Përpilim raporti i DSH-së “Plani i vlerësimit të rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera për territorin e komunës së Prishtinës”;
- Identifikimi i nevojave për plan të prioriteteve të vitit 2021 – DSH, bazuar në qarkoren buxhetore;
- Dëgjim publik me qytetarë – “Identifikimi i kërkesave në sektorin primar shëndetësor dhe nevojave të tyre për planifikimin e buxhetit për vitin 2021”.

4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Identifikimi i nevojave për ofrimin e shërbimeve shëndetësore cilësore edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Identifikimi i nevojave për lehtësimin e punës së përditshme të personelit shëndetësor edhe gjatë gjendjes emergjente si pasojë e pandemisë globale;
- Përgatitje teknike e vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

5.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

5.1.2. Takimet me palë.

5.1.3. Takimet me institucione të tjera:

- Drejtoria e Investimeve Kapitale;
- Drejtoria e Prokurimit;
- Zyra e regjenerimit urban.

5.1.4. Diskutime publike/takimet me qytetarë

Raportime të përditshme me medie lokale: RTV 21, RTV Dukagjini, TV Klan dhe RTK;

Dëgjim publik me qytetarë.

5.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

Lëndë të pranuar janë 37, 3 - SHJV dhe 3 - të ndryshme;
Lëndë për ndihmë financiare - 31.

5.1.7. Përfitues të subvencioneve

5.1.8. Takime të tjera

- MSH,
- IKSHP,
- QKMF,
- QMU.

6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunes apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

- Mungesa e stafit në DSH;
- Mungesa e shefit të DSH tani e sa vite;
- Mungesa e stafit shëndetësor në objektet KPSH;
- Trajnime të ndryshme të personelit - DSH, përgjegjësitë e përditshme zyrtare;
- Numri i jo mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë "Mallra dhe shërbime", ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve, bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;
- Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshme profesionale.

8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE

Edhe gjatë muajit gusht 2020, ka vazhduar organizimi i brendshëm, i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) ka vazhduar puna pa ndërprerje (24/7) në ndërresa të zakonshme (07:13:30; 13:30 – 19:00 dhe 19:00 – 07:00). Në katër qendra të tjera (QMF 2, QMF 6, QMF Besi dhe QMF Hajvali) është zbatuar orari i punës: 07:00 – 19:00, po ashtu, në ndërrime të zakonshme si më lart. Ky organizim i punës është bërë për të përballuar nevojat dhe kërkesat për zbatimin e masave, rekomandimeve dhe obligimeve tona kundruall parandalimit dhe frenimit të pandemisë COVID-19, përkundër mungesës së numrit të mjaftueshëm të personelit. Në qendrat tjera është punuar në një ndërrim, nga ora 08:00 – 16:00.

Nga java e fundit të qershorit 2020, kur kemi regjistruar rastet e para të infeksionit me COVID -19, në mesin e stafit mjekësorë dhe deri më 31 gusht 2020, kemi pasur 178 punonjës të infektuar (simptomatik apo sipas rezultateve të testeve) të QKMF-së, që për periudha të caktuara kohore (bazuar në rekomandimet e IKSHPKS), kanë qenë të izoluar dhe jashtë vendit të punës. Prej këtyre, 89 veta kanë qenë me COVID -19, të konfirmuar nga laboratorët (RT-PCR testi).

Në të gjitha QMF-të, në hyrje kanë vazhduar të qëndrojnë ekipet e përbëra nga (mjeku familjar dhe infermiera) për triazhimin e pacientëve. Gjatë kësaj periudhe kohore, i është mundësuar personelit shëndetësor shfrytëzimi i pushimit vjetor (deri në 5 ditë pune).

Nga 4 gushtit 2020, në përgjigje të nevojave të shtuara për administrimin e terapisë parenterale, në mënyrë ambulatorie, për qytetarët e infektuar me COVID-19 dhe me qëllim të reduktimit të mundësisë së përhapjes së infeksionit prej tyre, kemi adaptuar QMF 7 në Emshir, si Qendër për terapi parenterale për COVID -19. Stafi i të gjitha njësive të Mjekësisë Familjare ka dhënë kujdestari 12 orësh (maksimum 2 herë brenda muajit) në këtë qendër. Nga 4 – 31 gusht 2020, në këtë qendër janë ofruar gjithsej 2103 infuzione (1472 gjatë ditës në ndërresën me fillim nga ora 07:00 – 19:00; dhe 631 gjatë natës) me një mesatare prej 75 infuzionesh brenda 24 orëve dhe me variime prej 28 (ditën e parë) deri më 126 (18 gusht 2020).

Bazuar në trendin e kërkesës për këtë shërbim, prej 1 shtatorit 2020 puna në këtë qendër (QMF 7) vazhdon me të njëjtin shërbim, por me orar të organizuar në dy ndërresa: 08:00 – 16:00 dhe 16:00 – 24:00 dhe e përforcuar me staf.

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha QMF-të, (ndërresa e paradites, pasdites dhe ndërresa e natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze. Përkundrazi, gjithçka ka funksionuar si duhet.

Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik ka rifilluar punën në të gjitha QMF-të me orar të rregullt dhe përqendrim në shërbimet esenciale.

Shërbimi i vaksinimit – Që nga 1 qershori 2020, ka vazhduar punën me orar të rregullt dhe ka vazhduar vaksinimi i fëmijëve të porsalindur me BCG, Hepatit dhe vaksinimi i personave të lënduar me TeAl dhe Tetabulinë. Gjatë muajit gusht 2020, janë administruar 3493 vaksina.

Shërbimi laboratorik – Ka filluar me realizimin e testeve serologjike, nga 20 korriku 2020 në AMF në Qendrën e Studentëve. Gjatë muajit gusht, janë kryer mbi 1945 teste serologjike.

Përndryshe, gjatë muajit gusht 2020 janë realizuar gjithsej:

- ✓ 44654 - vizita mjekësore;
- ✓ 54698 - shërbime shëndetësore;
- ✓ 37799 - shërbime laboratorike (pa QKMF, QMF 3 dhe QMF 11);
- ✓ 7961 - shërbime stomatologjike;
- ✓ 1807 - shërbime radiologjike.

Të tjera:

Deri më 31 gusht 2020, në QKMF me njësitë e saj, kishim 178 punonjës shëndetësorë të izoluar, prej të cilëve 49 të konfirmuar si pozitiv në COVID -19 (shih listën e bashkangjitur për përdorim të brendshëm)!

REKOMANDIME

1. Shpalljen e konkursit për praninë të punonjësve të rinj, për shkak të pozitive të mbetura bosh nga pensionimi i stafit (mbi 40 pozita);
2. Planifikimin e nevojave për PPM dhe pajisjes tjera medicinale për përballimin e valës së dytë të pandemisë me COVID-19, në vjeshtë;

QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë periudhës raportuese, ka vazhduar të ofrojë shërbime urgjente për të gjithë banorët e Prishtinës dhe fshatrave që i takojnë komunës, me ekupe mjekësore dhe autoambulanca.

Në QMU gjatë muajt gusht kishte 11 punëtorë të infektuar me Covid -19 dhe të njëjtit ishin në vetizolim në shtëpi, sipas rekomandimeve të IKPSH-së.

Aktiviteti gjatë këtij muaji:

Më 25.08.2020, me kërkesën e Federatës së Futbollit të Kosovës, në Stadiumin e qytetit "Fadil Vokrri", asistuan në 2 seanca stërvitore të ekipit të KF, "Gjilani" dhe ekipit "Apoell" nga Greqia. Ndërsa më 26.08.2020, u asistua me një ekip mjekësor në stadiumin "Fadil Vokrri", në ndeshjen ndërkombëtare të kupës së UEFA-së, ndërmjet KF "Gjilani" - "Apoell". Ekipi intervenoi në fushë tek një lojtar, i cili pas trajtimit mjekësor vazhdoi aktivitetin e tij.

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të triazhës, por dominuan rastet me:

- Hipertension arterial,
- Gastroenterocolite acute,
- Colikat abdominale,
- Reakcionet alergjike,
- Gjendjet me stress psikotraumatik,
- Intoksikime alimentare,
- Aksidentet e trafikut etj.

QMU kishte mesatarisht rreth 200 thirrje gjatë 24 orëve në linjën emergjente -194, nga ana e qytetarëve, ku një numër i konsiderueshëm i qytetarëve u këshilluan si të veprohet në rast dyshimi për Corona-virus.

Nga Ministria e Shëndetësisë, në formën elektronike është pranuar MANUALI PËR MBROJTJE NGA PËRHAPJA E VIRUSIT COVID-19, i cili përmes adresave elektronike, iu ka shpërndarë të gjithë punëtorëve shëndetësorë në QMU.

Furnizimi me mjete mbrojtëse (veshje, maska, dorëza, kalaqe, syze) kundër Covid -19 ishte në nivelin e duhur. Furnizimi është realizuar nga Ministria e Shëndetësisë - Divizioni Farmaceutik dhe nga OE.

Rastet e rënda me COVID -19, të palëvizshëm dhe rastet që kërkojnë transport për trajtim spitalor, u kryen përmes personelit të QMU-së.

QMU gjatë kohës së pandemisë COVID -19, me përkushtim dhe angazhim maksimal të të gjithë stafit mjekësor dhe mbështetës, me sukses vazhdon të kryej detyrat dhe misionin e vet, duke iu ofruar ndihmë mjekësore të gjithë qytetarëve.

Ne vazhdimësi ekziston bashkëpunim me menaxhmentin e QKMF-së dhe stafin e të gjitha QMF-ve, si dhe Policinë e Kosovës, e cila asiston dhe siguron ekipet e QMU-së.

Finalizohen punime rreth renovimit dhe përmirësimit të objektit të QMU-së.

REKOMANDIM:

- Rritja e numrit të personelit shëndetësor, sidomos tani që jemi në prag të sezonit vjeshtë-dimër, kur edhe pritet rritja e infeksioneve virale.

Shërbimet dhe vizitat shëndetësore në QMU – gusht 2020:

1	Viz.Mj.Urgj.në terren	1187
	Viz.Mj. tjera	76
2	Vizita mjekësore në QMU	0
3	Shërbimi i kirurgjisë së vogël	0
4	Shërbimi i rea. në terren	0
	Shërbimi i rea. në QMU	0
5	Observim (intensiv)	0
6	Shërbimi i infermierisë	2
7	Aksidentet	67
8	Fatkeqësitë në punë	6
	Fatkeqësi të tjera	40
9	Shërbimi laboratorik	0
10	EKG	43
11	Transportet	196
12	Konstatim vdekjeje	78

GJITHSEJ

1695

